

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe Burim Shala e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.M. nga Ferizaj rr. “...” nr..., të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.H.I. nga Ferizaj, kundër të paditurës N.T.P “NN” me seli në Ferizaj, me pronar R.H., për shkak të kompensimit të të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.556/10, të datës 22.07.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.06.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit H.M. nga Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.556/10, i datës 22.07.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.556/10, të datës 22.07.2014, e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit H.M. nga nga Ferizaj, rr. “...” nr..., përmes të cilës ai kishte kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të përmbushjes së kontratës, paditësit t’ia paguaj të ardhurat personale në shumë prej 8,010.00 €, me kamatëvonesë prej 8 %, si të pa bazuar. Në pikën II të aktgjykimit është vendosur që secila palë t’i bartë shpenzimet e saj në procedurë. Kurse në pikën III të aktgjykimit gjykata e kishte obliguar paditësin që të paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 50.00 €, në afat prej 7 ditëve, pas marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe lëndën t’ia kthejë në rigjykim, ndërsa aktvendimin për taksën gjyqësore ta prishë.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe pretendimeve nga përgjigja në ankesë lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 30.12.2014, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, paditësi H.M. ka paraqitur padi kundër të paditurës N.T.P “NN”, për përmbushjen e kontratave – pagimin e të ardhurave personale, vlera e kontesit 8,010 €, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, me datën 22.07.2014 e ka caktuar seancën kryesore në të cilën, ndër të tjera, ka marrë aktvendim duke e refuzuar propozimin e paditësit për dëgjimin e palëve pasi që ka konsideruar se në këto rrethana për të cilat janë propozuar për tu dëgjuar, dëshmia e tyre nuk mund të vërtetohet ndonjë fakt, ngase këto fakte paditësi duhet t'i ofrojë në formë të shkruar. Gjykata në fjalë gjithashtu e ka refuzuar propozimin që të kryhet ekspertiza financiare dhe propozimin për dëgjimin e palës paditëse H.M. në cilësi të palës.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.556/10, të datës 22.07.2014, me të cilin, e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka obliguar paditësin që të paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 50.00 €, në afat prej 7 dite, pas marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka theksuar se ekziston marrëdhënia e punës mes paditësit dhe të paditurës, e cila vërtetohet me kontratën e punës të datës 29.08.2002, me nr.277, në bazë të së cilës janë përcaktuar obligimet dhe të drejtat ndërmjet palëve kontraktuese. Në bazë të kësaj kontrate nuk është paraparë obligimi i punëdhënësit, që duke u bazuar në kontratën mbi komercializmin e lidhur në mes Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe të paditurit R.H., e datës 31.01.2002, të rriten pagat për çdo vit sipas aneksit 6. Gjithashtu ka theksuar se kontrata e komercializimit e lidhur në mes të ish UNMIK-ut dhe të paditurit ka përfunduar me datë 21.09.2007, kurse paditësi padinë e ka paraqitur në gjykatë me datën 22.12.2010, që do të thotë se ka kaluar mbi tre vite nga data e përfundimit të kontratës së komercializimit dhe kërkesa nga padia e paditësit mbi këtë bazë është parashkruar andaj edhe është refuzuar sipas nenit 372 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm. Gjykata ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestuese duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që gjykata të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie. Pretendimi ankimor i paditësit është paraqitur në formë të përshkrimit të dispozitës së nenit 182 paragrafi

2 pika (n) e LPK-së, pa dhënë arsyeje specifike se cilat të meta të dispozitivit apo të arsytimit përbëjnë shkelje, prandaj Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar një pretendim të tillë.

Pretendimet për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë procedurë, ngase që është provuar fakti i parashkrimit, sepse padia e paditësit është parashtruar pas kalimit të afatit ligjor 3 vjeçar të paraprë me nenin 372 të Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (i vitit 1978 i zbatueshëm në këtë rast), në të cilin decidivisht parashihet se *“kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtëra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike akcesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesa periodike të atilla në të cilat soset vetëm e drejta, sikundër është kërkesa e ushqimit, parashkruhen tre vjet nga rrjedha e secilës dhënie të veçantë për pagesë”*. Është i drejtë konstatimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret, pas datës 21.09.2007, ka përfunduar kontrata e komercializimit, andaj në këtë bazë edhe ka përfunduar edhe obligimi i të paditurës që të përmbushë obligimet nga e njëjta kontratë, prandaj si pasojë e këtij fakti nga data 21.09.2007, kontrata në fjalë më nuk prodhon efekte juridike as ndaj perosnave të tretë. Kështu që duke marrë për bazë se padia e paditësit është parashtruar me datën 30.12.2010, del se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë e ka refuzuar kërkespudinë e paditësit mbi bazën e faktit të parashkrimit.

Nuk qëndrojnë as pretendimet e paditësit se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar në lidhje me taksën gjyqësore ka bërë shkelje të nenit 10.02 të vendimit për pagesën e taksës gjyqësore, sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka detyruar paditësin të paguaj taksën gjyqësore, sepse në kotestin në fjalë paditësi nuk kuaifikohet si i tillë që i njëjti të jetë në grupin e procedurave të cilat janë të liruara nga pagesa e taksës gjyqësore. Me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore (të vitit 2012), parashihen kategoritë e personave të cilat janë të liruara nga pagesa e taksës gjyqësore, kur me nenin 7.1. ceket se nga pagesa e taksave gjyqësore, ndër të tjerë, është i liruuar *“personi i cili parashtron kërkesën që ka të bëjë me marrëdhënien e punës, përveç kërkesave në të holla...”*. Në rastin konkret kontesti ka të bëjë me kërkesën në të holla, përkatësisht kompensimin e të ardhurave personale të paditësit.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3361/14, me datë 29.06.2018

**Kryetari i kolegjit – Gjyqtari
Valon Totaj**